

*Shërbimi i Sancës
30.9.2025*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 2648 Prot.

Tiranë, më 29/09 /2025

Lënda: Kërkesë për interpelancë urgjente me kryeministrin Edi Rama

Baza Ligjore: Neni 80, pika 1 e Kushtetutës dhe neni 97 i Rregullores së Kuvendit

Drejtuar: Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë

Departamenti Amerikan i Shtetit në Raportin mbi Shqipërinë për vitin 2025 lidhur me Klimën e Investimeve, ndër të tjera thekson se ekonomia shqiptare mbetet e ndjeshme ndaj krimit të organizuar, si dhe thekson se komuniteti i biznesit raporton praninë e madhe të të ardhurave të paligjshme nga trafiku i drogës që shtrembëron konkurrencën në treg. Është e qartë se një konstatim i tillë nga Departamenti Amerikan i Shtetit nuk është as sajesë dhe as një deklarim rastësor.

Në datën 23 shtator 2025, gazetari italian Nello Trocchia¹, i njohur për investigimet lidhur me mafian, citon prokurorin e Antimafias Italiane, Nicola Gratteri, i cili shprehet se: “*Nuk është ekzagjerim ta quash Shqipërinë një narkoshtet, përkundrazi. Shqipëria është shndërruar në një lloj Eldorado të rrjedhjes së parave cash, dhe mafia shqiptare një fuqi ekonomike dhe financiare.*”.

Më tej, gazetari investigativ italian pëershkruan rrugëtimin e grupeve kriminale shqiptare nga vitet 90' deri më sot. “*Një pakt me klanet italiane shënoi fillimin e karrierave kriminale të shqiptarëve: së pari, si kontrabandistë dhe trafikantë, pastaj si banditë dhe vrasës të paguar nga krimi i organizuar dhe së fundmi si trafikantë droge, që, sot, janë jashtëzakonisht të fuqishëm dhe kontrollojnë qendrat e shpërndarjes dhe portet në të gjithë botën. Ata ishin gjithashtu trafikantë njerëzish, duke transportuar emigrantë në Itali edhe pse qeveria italiane shpenzonte miliona për t'i mbajtur ata në qendrat që kishte ndërtuar në Shqipëri. Pas “Casamonica”, Nello Trocchia rikthehet me një investigim të madh për të treguar intrigat dhe trajktoren e një majtie që, nga Roma, u bë një fuqi ekonomike dhe financiare ndërkombëtare, duke ndjekur protagonistët e saj më të egër në një rritje që duket e pandalshme.*”²

¹ Gazetari ka publikuar librin “*Të pamposhturit. Mafia shqiptare nga Roma drejt pushtimit të botës*”.

² <https://www.amazon.it/Invincibili-mafia-albanese-conquista-mondo/dp/8817188522>

Veçanërisht me rëndësi është investigimi mbi një takim të fshtehtë të zhvilluar në periudhën 24–31 Janar 2019, në ishullin Aruba, në Karaibe, zyrtarisht territor i Mbretërisë së Hollandës. Sipas dokumenteve të sigurara nga Antimafia Italiane, në këtë takim kanë marrë pjesë biznesmenë, eksponentë të krimit të organizuar dhe **përfaqësues të qeverisë shqiptare në detyrë, të afërt me kryeministrin Edi Rama**. Sipas hetuesve, gjatë këtij takimi është diskutuar për ndërtimin e një kulle në Tiranë, në një truall që rezulton në pronësi të dy grupeve kriminale. Për realizimin e këtij investimi ishte e nevojshme mbështetja dhe miratimi nga nivelet e larta të qeverisë shqiptare, të cilat sipas përgjimeve ishin të pranishëm në Aruba dhe diskutonin për ndarjen e përsfitimeve. Këto fakte janë konfirmuar jo vetëm nga përgjimet telefonike, por edhe nga burimet e Policisë gjermane.³

Në vendë të këtij rrjeti që lidh krimin e organizuar me politikën qëndron shtetasi Artur Shehu, një personazh i njojur në qarqet kriminale dhe sipërmarrëse, me bazë në Miami, SHBA dhe Vlorë, Shqipëri. Ai përshkruhet nga hetuesit si kreu i një organizate të fuqishme kriminale shqiptare që ka ndërtuar një perandori ekonomike përmes trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe pastrimit të parave. Pikërisht, Artur Shehu, së bashku me një tjetër personazh të quajtur Genci Hamzai, dhe përfaqësues të qeverisë Rama, kanë marrë pjesë në takimin në Aruba, Antillet Hollandeze, ku u përcaktuan hapa konkretë për investimet e ardhshme. Hetuesit theksojnë gjithashtu se falë mungesës së hetimeve financiare në Shqipëri, Artur Shehu ka arritur të ndërtojë një perandori ndërtimi dhe investimesh në Vlorë, Shqipëri dhe Toskana, Itali, duke përdorur kredi që i shërbejnë për pastrimin e parave. Në këtë shkrim përmendet edhe Fabrizio Lisi, ish-gjenerali i Guardia di Finanza, i cili në vitin 2015, do të përfitonë tridhjetë mijë metra tokë në Vlorë pikërisht nga Artur Shehu.⁴

Sjellim në vëmendje se në Prill 2024, emisioni “Report”, në Rai 3, publikoi një cikël emisionesh lidhur me lidhjet e politikës shqiptare me mafian. Në këto emisione përmendej shprehimisht edhe Artur Shehu, i cili i kishte dhuruar kreut të Interpolit Italian në Shqipëri në periudhën 2014 – 2015, Fabrizio Lisi, një pronë 30 mijë metra katorë në Vlorë. Dhurimi ishte kryer për një fondacion, i cili në periudhën 2012-2013, kishte pasur si kurator të atëhershëm Ëngjëll Agaçin.⁵ Ky i fundit kishte qenë pikërisht personi që bëri prezantimin dhe ndërmjetësimin e gjeneralit Fabrizio Lisi me Artur Shehun.⁶

Ëngjëll Agaçi, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave nga Shtatori 2013 e në vijim, përpala se të merrte këtë detyrë, kishte qenë gjithashtu avokat i grupeve kriminale të

³ <https://www.editorialedomani.it/fatti/invincibili-caraibi-documenti-incontro-segretario-boss-mafia-uomini-rama-albania-mq60qurs>

⁴ <https://boldnews.al/2025/09/24/takimi-sekret-ne-ishujt-karaibe-mes-boseve-te-krimit-dhe-njerezve-te-rames/>

⁵ <https://prapaskena.com/2024/04/24/avokat-i-boseve-shqiptar-te-krimit-ne-itali-publikohen-pergjigjet-e-engjell-agacit-per-investigimin-e-rai-3/>

⁶ <https://boldnews.al/2024/04/22/toka-dhurate-nga-artur-shehu-ish-kreu-i-interpol-lisi-ma-solli-engjell-agaci/>

narkotrafikut në Itali, përfshirë edhe grupin kriminal të Artur Shehut.⁷ Sipas investigimeve të kryera nga media shqiptare, Artur Shehu rezulton si një nga përsituesit më të mëdhenj të sipërfaqeve të konsiderueshme të tokave në Zvërnec, Ujin e Ftohtë, Karaburun dhe Palasë nëpërmjet procedurave të dyshimta, për të cilat ka pasur kallëzime penale nga banorët dhe personat e dëmtuar, por akoma pa ndonjë rezultat konkret.⁸

Për t'u rikthyer sërisht te gazetari italian Nello Trocchia, në një intervistë të dhënë për median shqiptare tregon se: “*Unë zbuloj për herë të parë që Drejtoria Hetimore Antimafia e shkruan e zeza mbi të bardhë, ashtu si edhe policitë e tjera ndërkombëtare, se në vitin 2019, u zhvillua një takim në Aruba të Antileve Hollandeze. Kjo shkruan Drejtoria Hetimore Antimafia, në praninë e njerëzve që DIA i identifikon si të lidhur me një grup kriminal, në praninë e Artur Shehu që tashmë është bërë bosi i bosëve të biznesit, dhe në praninë edhe, sipas policisë gjermane, të Genci Hamzai, që është i njohur si trafikant droge. Në praninë edhe të përfaqësueve të qeverisë aktuale shqiptare, asaj të Ramës, sepse në 2019 ishte qeveria Rama. Unë i shkruajta Edi Ramës, si përmes WhatsApp, ashtu edhe përmes sms, emailit zyrtar të zëdhënësit të tij për të kërkuar diçka të thjeshtë: A e keni takuar ndonjëherë Artur Shehun? A keni qenë ndonjëherë në Aruba? A ka të regjistruar udhëtime të ministrave të tij në 2019? A ekzistojnë takime me Artur Shehun, udhëtime në Aruba?”.*⁹

Më tej gazetari Trocchia shprehet se në dokumentet e analizuara përmenden: “...*drejtuesit e lartë. Pra, ose ministrat ose zëvëndësministrat. Është e qartë që ata përmendin këtë lloj reference. Ka edhe biseda të përgjuara, ku flitet për njerëz të lartë të qeverisë së Edi Ramës, duke përmendur Edi Ramën si kreu i qeverisë. Kush ishte aty duhet të sqarohet; për këto pyetje Edi Rama nuk ka pranuar të përgjigjet.*”¹⁰

Sjellim në vëmendje se gjithashtu emri i Edi Ramës dhe Erion Veliaj përmendej edhe në vitin 2021, në përgjimet e publikuara asokohe nga Antimafia Italiane e Katanzaros, në të cilat rezultonin shtetas shqiptarë, së bashku me eksponentë të organizatës mafioze të Ndragheta, që diskutonin për pastrimin e parave në kullat që ndërtohen në Tiranë, duke paguar një përqindje e caktuar te kryeministri dhe kryetari i Bashkisë.¹¹

Në këto kushte, pasur parasysh se: i) trafiku ndërkombëtar i lëndëve narkotike nga grupet kriminale shqiptare përbën një shqetësim në ritje dhe të vazhdueshëm për partnerët tanë, që së fundmi konfirmohet edhe nga Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit; ii) grupet kriminale

⁷ https://www.repubblica.it/politica/2024/04/21/news/report_migranti_italia_albania_santanche-422666123/?ref=drift-1

⁸ <https://kapitali.al/gjurmet-e-artur-shehut-ne-vlore>

⁹ <https://www.youtube.com/watch?v=Yj4YUEl5dYM>

¹⁰ <https://www.syri.net/politike/823791/intervista-e-plote-nga-gomonia-ne-ishullin-aruba-gazetari-italian-zbulon-biznesmenin-vlonjat-te-afert-me-ramen-video/>

¹¹ <https://www.reporter.al/2021/02/04/spak-fillon-hetimet-per-pastrimin-e-parave-te-kullat-e-tiranes/>

përdorin ekonominë shqiptare dhe veçanërisht sektorin e ndërtimit për pastrimin e parave; iii) eksponentët e krimit të organizuar përfitojnë leje ndërtimi, licenca dhe tendera nga qeveria shqiptare; dhe iv) ekzistojnë fakte, të dhëna, prova dhe indicie të shumta për lidhjet e krimit të organizuar me nivelet më të larta të qeverisë shqiptare; lindin disa pyetje që kërkojnë shpjegime nga ana e Kryeministrit të Shqipërisë, që është njëherazi edhe Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, si më poshtë:

- *A ka dijeni Kryeministri Edi Rama për takimin e dokumentuar nga Antimafia Italiane të zhvilluar në periudhën 24–31 Janar 2019, në ishullin Aruba, në Karaibe, zyrtarisht territor i Mbretërisë së Hollandës?*
- *Kush janë eksponentët e lartë të Qeverisë shqiptare, që kanë marrë pjesë në atë takim dhe a është informuar Kryeministri Edi Rama prej tyre apo shërbimeve të sigurisë kombëtare mbi përbajtjen e takimit?*
- *A ka përfituar shtetasi Artur Shehu, apo persona të lidhur me të, leje ndërtimi; licenca; punë publike; marrëveshje koncesioni apo partneriteti publik-privat; prokurime publike apo fonde publike, nga Qeveria Shqiptare apo institucionet nën varësinë e ekzekutivit?*
- *A është takuar ndonjeherë Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama me shtetasin Artur Shtetit, apo ka zhvilluar ndonjëherë takime qeveritare apo elektorale në pronat e paluajtshme në pronësi të këtij shtetasi, që rezulton të jetë një person i skeduar nga disa agjenci ligjzbatusë si drejtues i një organizate ndërkombëtare kriminale të trafikut të drogës?*
- *Cfarë masash ka marrë Kryeministri, si drejtues i Këshillit të Ministrave, për të parandaluar që krimi i organizuar të ketë ndikim të ndjeshëm në ekonominë shqiptare, apo të mos dëmtojë konkurencën e lirë në treg, sic citon edhe Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit?*

Me qëllim dhënien e informacioneve dhe shpjegimeve lidhur me sa më lart, në cilësinë e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 97, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, kërkojmë:

- Zhvillimin e një interpelance urgjente me kryeministrin Edi Rama lidhur me cështjet e sipërcituara dhe me fokus ndikimin e krimit të organizuar në ekonomi dhe fuqizimin e tij përmes lejeve, licencave apo fondeve publike, që shërbejnë si mekanizëm për pastrimin e parave të pista.

Për sa më lart, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit kërkojmë nga Kryetari i Kuvendit që kërkesën për interpelancë urgjente t'ia njoftojë Kryeministrit Edi Rama dhe ta përfshijë atë si pikë të parë të Rendit të Dities në seancën më të parë plenare të javës në vijim.

D E P U T E T Ë T

1. Feh Naseri Mulla
2. Gazment Bërdhi Bajraktar
3. Jevole Tëshmi J
4. Afroj Beçimaj Ryu
5. Lulzim Boçiqaj
6. Ira Zhepi ~~Zhepi~~
7. Gjermes Nolaq Aliu